

Dritan MUSTAFA**Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv**

Z. Mustafa u bë pjesë e Triana Bank në Dhjetor 2014 si Zv. Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe u emërua Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Komanduar në Janar 2015, duke marrë përsipër përgjegjësinë e Kryetarit të Komitetit Ekzekutiv, Zv. Kryetarit të Këshillit Drejtues të Tirana Bank dhe Anëtarit të Këshillit Drejtues të Tirana Leasing. Që prej Nëntorit 2016, z. Mustafa është ngarkuar me detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv në Tirana Bank.

Z. Mustafa ka eksperiencë në sistemin bankar prej vitit 1995 në banka si BKT, NBG dhe Credit Agricole, kryesisht në pozicione drejtuese duke përfshirë edhe pozicionin e Zv. Drejtorit të Përgjithshëm që prej vitit 2004. Z. Mustafa është diplomuar në Universitetin e Tiranës në degën Administrim Biznes dhe zotëron një diplomë Master për Administrim Biznesi akorduar nga International Hellenic University, Selanik.

Eralda TAJAJ (Gurga)**Drejtuese e Divizionit të Operacioneve**

Znj Tafaj ka një përvojë 11 vjeçare në sektorin bankar, duke mbuluar poste të rëndësishme të tilla si Drejtore e Auditimit të Brendshëm dhe Zëvendës Drejtore e Operacioneve në Bankën Emporiki në Shqipëri (aktualisht Banka Credit Agricole në Shqipëri) dhe që nga muaji gusht 2009 ajo ka mbuluar pozicionin e Drejtores së Operacioneve në NBG Shqipëri. Ajo gjithashtu ka punuar për 3 vjet për KPMG dhe 1 vit për UNDP, në fillim të karrierës së saj profesionale.

Znj Tafaj ka një diplomë Bachelor në Administrim Biznesi nga Universiteti i Tiranës dhe gjithashtu një MBA në Ekonomi, në fushën e Menaxhimit po në Universitetin e Tiranës.

Manjola CAPO**Drejtore e Dizivionit të Kredisë**

Znj. Capo, lindur në vitin 1976, diplomuar në Shkenca Ekonomike, specializuar në Financë Bankare, bashkohet me Tirana Bank në vitin 2005 si Oficer i Marrëdhënieve të Korporatës, duke sjellë një eksperiencë 4 vjeçare nga tregu bankar shqiptar.

Në vitin 2007 emërohet Drejtuese e Marrëdhënieve të Korporatës. Pas një pune 5 vjeçare të suksesshme në Korporatën Bankare, në vitin 2010 emërohet Drejtore e Departamentit të Menaxhimit të Riskut të Kredisë, tashmë Divizion dhe nga Qershori 2011 është Anëtare e Komitetit Ekzekutiv të Tirana Bank, anëtare e Komitetit të Kredisë, Komitetit të Menaxhimit të Aktiveve dhe Pasiveve (ALCO).

Elona GJIPALI**Drejtores e Divizionit të Rekuperimit Bankar**

Znj Gjipali ka një Master në Drejtimin Bankar nga Universiteti “New York” i Tiranës, gjithashtu dhe një Diplomë Bachelor në Ekonomi nga Universiteti i Tiranës.

Znj Gjipali iu bashkua grupit në tetor të vitit 2001, ajo ka 15 vjet përvojë në sektorin bankar shqiptar, duke mbajtur poste të rëndësishme si Drejtores e Auditit të Brendshëm të Tirana Bank për 12 vjet.

Që nga viti 2013 ajo është anëtare e Komitetit Ekzekutiv të Bankës.

Elvira KAPOLI**Drejtuese Financiare**

Znj. Kapoli është pjesë e Bankës Tirana që prej muajt Shkurt 2019, në pozicionin e Drejtueses Financiare si dhe anëtare e Komitetit Ekzekutiv të Bankës. Znj. Kapoli ka rreth 11 (njëmbëdhjetë) vjet eksperiencë si Drejtuese Financiare në sistemin bankar në Shqipëri. Më parë ajo ka mbajtur pozicionin e Auditorës me Eksperiencë në një nga kompanitë e auditimit.

Znj. Kapoli zotëron një Master Shkencor dhe një Diplomë të Specializuar në studimet Pasuniversitare pranë Departamentit të Shkencave Ekonomike/Marketingut dhe Financës nga Qendra Ndërkombëtare e Studimeve Mesdhetare të Avancuara në Kretë, Greqi dhe Diplomë Bachelor në Financë – Kontabilitet nga Universiteti i Tiranës.

Lila CANAJ**Drejtuese e Retail-it**

Znj. Lila Canaj është pjesë e Bankës Tirana që prej muajt Majit 2013. Së fundmi ajo është emëruar në pozicionin e Drejtueses të Retail-it si dhe anëtare e Komitetit Ekzekutiv të Bankës.

Më parë ajo ka mbajtur pozicionin e Drejtueses të Departamentit të Bankingut Privat dhe Institucioneve të Biznesit si dhe pozicionin e Drejtueses të Rrjetit të Degëve.

Znj. Canaj ka 14 vjet eksperiencë në sektorin Bankar në Shqipëri, duke mbuluar pozicione si Account Manager e SME-ve & Korporatave dhe Loan Center Manager pranë Bankës Raiffeisen si dhe Drejtore e Segmentit të Individëve dhe Institucioneve Shtetërore pranë Bankës ProCredit.

Znj. Canaj zotëron një Diplomë Bachelor në Administrim Biznesi nga Universiteti i Tiranës.

Glenda KURTI**Drejtores e Divizionit të Korporatave**

Znj. Glenda Kurti është pjesë e Bankës Tirana që prej muajt Mars 2019, në pozicionin e Drejtores të Divizionit të Korporatave si dhe anëtare e Komitetit Ekzekutiv të Bankës.

Znj. Kurti ka 13 vjet eksperiencë në sektorin Bankar në Shqipëri, duke mbuluar pozicione të larta në fushën e korporatave pranë Bankës Societe Albania si dhe pranë Bankës Raiffeisen.

Znj. Kurti zotëron një Master në Administrim Biznesi nga Universiteti Epoka si dhe Diplomë Bachelor in Administrim Biznesi nga Universiteti i Tiranës.